



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 49

Datë: 27.01.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-X- (dhjetë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës.
- 2.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Integritetit për vitin 2022.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Shërbime Publike.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Kuvendit për vitin 2023
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06.300 datë: 07.12.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë:11.10.2022 e parashtruar nga Bashkësia Islame në Malishevë, për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbime të varrimit.
- 8.Shfuqizimi i vendimit për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesëm, sipas kërkesës së MAPL-së nr.453-399/1 datë:11.05.2022.
- 9.Shfuqizimi vendimit nr.02/319, për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC “ Malisheva” në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-607/1 datë:12.07.2022.
10. Shfuqizimi i Vendimit nr.02/499, dt.24.10.2022, për lejimin e rregullimit të murit mbrojtës të varrezave publike në fshatin Shkozë, Komuna e Malishevës, sipas shkresës së Ministrisë për Mjedis, Planifikim Hapësinorë dhe Infrastrukturë nr.020-945/6 datë:02.11.2022.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02./598 datë: 01.12.2022.
- 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02.629 datë:19.12.2022.
- 13.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/594 datë: 29.11.2022
- 14.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/602 datë: 01.12.2022.
- 15.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 28.12.2022 dhe filloi në ora: 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 24 asambleistë, drejtorë komunal, përfaqësues nga Kfori Zvicëran dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dhjetë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Para se të fillojmë më rendin e ditës, a ka dikush të deklaroj ndonjë qështje jashtë rendit të ditës?
Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Dua ta ngris një shqetësim për gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Është viti i dytë me radhë që po përballemi me një gjendje jo të mirë energjetike që po ju shkakton probleme të mëdha bizneseve dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës. Ne si Komunë duhet të ngrisim zërin më shumë te niveli qëndror që të trajtohet sa më mirë dhe të intervenohet sa më parë që të rregullohet sistemi i energjis në Komunën tonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Në emër të grupit ju uroj të gjithë mërgimtarëve pushime sa më të mira në Kosovë.

Unë dua ta ngris qështjen e energjis elektrike. Kërkoj nga Kryetari i Komunës të merr ndonjë iniciativ që të krijojmë ndonjë protestë, të bllokojmë ndonjë rrugë, të kërkojmë në qeveri që të bëjnë zgjidhjen e problemit të energjisë elektrike.

Qështja tjetër është që mundësisht email-at që po na dërgoni të i pastroni, sepse po na përsëriten materialet e mbledhjeve. Unë kam propozim që email-at të dërgohen me grupe.

Argjend Thaçi: Urdhëro Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

E cekën parafolësit që qytetarët e Malishevës, në veqanti mërgata jonë e pret me padurim të vijë në Kosovë dhe t'i kalojnë festat me familje, por fatkeqësisht ata po ndjehen shumë keq me këtë gjendje që jemi duke e kaluar ne si qytetarë. Unë këtë shqetësim e kam shprehur para disa muajve dhe kam kërkuar nga Kryetari i Komunës që ta formojë një komision dhe me pas një kordinim ose një presion ndaj KEDS-it, sepse KEDS-i është ka i injoron qytetarët e Malishevës. Kisha kërkuar nga Kryetari që ta merr më seriozisht këtë qështje në bashkë kordinim dhe me përfaqësuesit e partive të tjera që të marrim masa urgjente për një zgjidhje të këti problemi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë, faleminderit Kryesues!

E cekën shqetësimin e energjisë elektrike që është shqetësim për të gjithë ne, mirëpo Kryetari i Komunës dhe qeveria komunale nuk janë duke qëndruar duar kryq. Dje kryetari i komunës ka marrë pjesë në protestë, ka kërkuar gjatë gjithë kohës me u taku me drejtorin ekzekutiv të KOST-it, për me diskutu rreth kësaj qështje. Unë mendoj se ne si qeveri komunale, si asambleistë dhe si qytetar të bëjmë protesta të vazhdueshme dhe të tregojmë që jemi kundër kësaj problematike dhe të na trajtojnë si të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

I bashkangjitem shqetësimeve të parafolësve në lidhje me gjendjen e rënduar energjetike. Në këtë sezon ku janë ardhur mërgimtarët tanë, temperaturat janë më të ulëta dhe duket që komuna e Malishevës është duke u diskriminuar në raport me komunat e tjera të Republikës së Kosovës. Përveq këtij shqetësimi, desha të bëjë një rifreskim ku para një viti ne kemi fillu mandatin në këtë kuvend, për mua ka qenë mandati i parë dhe sot është mbledhja e fundit e rregullt e këtij viti. Gjatë këtij viti jemi munduar që ti përmbahemi disa parimeve bazë të cilat janë: 1. Vazhdimisht kam qenë përkrahës i proceseve të kryetarit dhe të ekzekutivit në përgjithësi që të i shtyjme proceset përpara që të përfundojnë punët në interes të qytetarëve. Po ashtu kam qenë i rregullt në seanca dhe nuk jamë nis nga ajo që t'i bojkotojë apo të mungoj në seanca. Jam munduar që ta jap maksimumin tim dhe jam munduar që të jem bashkëpunues si me kolegët dhe me qytetarët. Jam mjaftë i zhgënjyer e them këtë duke u bazar në gjendjen reale dhe zhvillimet që kanë ndodhur në Malishevë, nëse i krahasojmë investimet në infrastrukturë të këtij viti që po e lëjmë pas 2022 me vitin 2021 shihet një disproporcion shumë i madh. Disa vrejtje fshatrat siç janë Shkozë, Pagarush, Lubizhdë, Goriq, Drenoc etj, ka pasur shumë pak investime pra kemi ngecje në administrimin e projekteve të parapara në projekt buxhetin 2021-2022-2023. Dua të ndalem në fshatin Turjakë në planifikimin dy vjeçar që është dhënë në Draft-buxhetin e vitit të kaluar 2021-2022 kanë qenë të përfshira për asfaltim disa rrugë ku shumica prej tyre që janë parapara janë zbatuar gjatë verës të vitit 2021, përveq rrugës "Lulzim Kastrati" në Turjakë. Te rregullimi i kësaj rruge ka qenë e bllokuar dhe opsioni të rregullohet me kubëza, por nuk ka ndodhur as kjo. Në seancën që është aprovuar buxheti unë i kam propozuar disa rrugë të tjera të fshatit Turjakë dhe ato janë aprovuar nga ky kuvend, dhe janë futur në buxhet dhe çdo projekt që është fut në buxhet duhet të zbatohet, por kemi ardhur në një situatë dhe jemi në fund të vitit dhe nuk besoj që mund të përfundoj diçka mbrenda këtyre ditëve që kanë mbetur. Ajo çka po më shqetëson është dhe problemi me kanalizime, po ashtu te shtrati i lumit Mirusha që vazhdimisht ka vërshime dhe dalje të lumit nga shtrati, mos evitimi i ujrave fekale nga lumi, mos shtruarja e asfaltit në rrugën e cila fillon në Malishevë nga ura e deri në tranzit që ka qenë e parapara që të bëhet asfaltimi në të dyja anët. E kemi një shqetësim tjetër nga fermerët të cilët në buxhetin e vitit 2021-2022 është parapara të ndihmohen me subvencione përse ata nuk e kanë marrë këtë mbështetje. Në seancën e buxhetit të vitit 2023 ka pasur dritën admirale për të bajtur një rialokim apo për një ridestininim të mjeteve mirëpo as këto dhe as projektet të cilat kemi pritur të përfundojnë deri më tani nuk kanë përfunduar dhe qytetarët normalisht që presin, sepse e kanë ditur që këto projekte janë të futura në buxhet dhe presi që në të ardhmen të rregullohen.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Pa dashur të i përsëris gjëra e njëjta të cilat i cekën dhe kolegët tjerë ku folën për një shqetësim shumë të madh që po na shqetëson të gjithëve, qështja e energjisë elektrike në Komunën e Malishevës. Situata kërkon zgjidhje konkrete dhe ne jemi këtu të thirrur si kuvend dhe si

qeverisje komunale me ju dal zot këtyre shqetsimeve të qytetarëve. Nuk është hera e parë që KEDS-i është ka e sfidon Komunën e Malishevës, sepse para pak muajve vetë Nënkryetari na ka tregu që KEDS-i për arsye të mbulimit të humbjeve që i ka pasur i ka stopu projektet që i ka parapa në Komunën e Malishevës, qoftë për rrjetin e lartë energjetik, qoftë për ndërtimin e stacionit 200kë, pra të gjitha këto projekte i ka stopu. Në një seanc tjetër kryetari e ka cekë që ka bërë dhjetra kërkesa e lutje për një shtyllë që e ka penguar rrugën te mini tranziti, te hyrja e Kastratit, është dashur që komuna të pres me javë apo muaj të tërë me ardh me rregullu atë shtyllë. Kjo është sfidë e hapur që KEDS-i po e bënë dhe ne po qëndrojmë duar kryq. Çdo rrugë apo formë që qeverisja Komunale e sheh si zgjidhje, ne si grup i VV-së jemi të gatshëm ta mbështesim, qoftë protesta dhe çdo gjë.

Po ashtu kam dhe disa qështje të cilat dëshiroj t'i ngris. E para ka të bëjë me ndërtimet e blloqeve banesore që janë duke ndodhë te QKMF-ja dhe te Gjimnazi, ne nuk jemi kundër ndërtimit dhe mirë që po ndërtohet dhe po merr qyteti një pamje urbane. Mirëpo unë i kam vizituar një javë para ato ndërtime dhe kam parë që nuk është duke u respektuar asnjë kriter i ndërtimit. Ne duhet të i shohim se kush ja ka dhënë ato leje ndërtimi dhe duhet me i pa se si po shkojnë ato leje ndërtimi. Dhe një leje ndërtimi dëshiroj ta di se si e ka marrë një pronar që ka fillu ta ndërtoj një pompë të derivateve në mes qyteti, ku kanë qëndru kamionët e zhavorit. Dua të di se si ja ka dhënë komuna lejen, sepse me ligj është e shënuar që kesi lloj biznesesh nuk mundën me u hapë më afër se 500m largësi nga zona urbane.

Drejtor, ta kam bërë një pyetje dhe më herët dhe nuk jam duke i parë që janë duke u zhvilluar këto në teren, është qështja e riparimeve të rrugëve lokale tashmë është sezona e dimrit dhe ka më shumë problemet. Është thënë që është nënshkruar kontrata dhe pritet të zbatohet në teren po flas për atë zonën rreth bjeshkëve Berisha, rrugët janë në gjendjen më të keqe. Është mirë që me i marrë do hapa dhe me i rregullu.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Po ju bashkangjitem parafolësve, sepse gjendja me furnizim të energjis elektrike në Komunën e Malishevës është tmerrësisht e keqe. U cekë diskriminimi i KEDS-it, mirëpo duhet çdo problematik që ka të bëjë me qytetarët e Malishevës adresa duhet me qenë te Komuna, sepse duhet të bëhet presion. Unë disa herë e kam ngritur një qështje për disa investime të KEDS-it e di që përgjigjia e ekzekutivit do të thotë KEDS-i nuk është kompetenc e jona, por për projektet të cilat përfundojnë sidomos shtyllat elektrike që pa pëlqim të KEDS-it asnjë shtyllë elektrike nuk mund ta vendosësh. Presione duhet me bërë dhe duhet të krijohen raporte korrekte të bashkëpunimit.

Një qështje tjetër në seancën e fundit kuvendi ka formu një komision për ndihmë biznesesh për gjatë rrugës "Ibrahim Mazreku" dëshiroj një informat a është mbledh komisioni dhe cili është vendimi që e kanë marrë.

Një qështje tjetër po fillojmë në vitin e 4 që shkollat janë ende pa Drejtorë, po flitet që është anulë konkursi dhe ky problem duhet të zgjidhet.

E kemi parë një projekt që është bërë për fazën e parë të kolektorit Bubël, disa punime janë bërë, pra qështjen e kanalizimeve e kemi shumë keq në çdo fshat e di që kanë probleme, kisha dashur të di deri ku kanë shkuar punimet?

4 vite i ka salla e Edukatës Fizike në shkollën ku unë punoj dhe është bartur vit pas viti dhe nuk ka gjetur zbatim.

Problemi që e shoh për mos realizimin e projekteve janë bartja vit mbas viti, ka projekt 5-6 vite që nuk janë kryer dhe ka projekte që këtë vit është votuar dhe ka gjetë zbatim.

Te pagesat e Komiteteve të cilat janë funksionale në Malishevë nuk janë bërë dhe përgjigjen e kemi marrë nga Drejtori në seancën e kaluar që e ka cekë që kemi formu komitete shumë, nëse kemi formu komitete shumë atëherë vazhdojmë vetëm me dy që i kemi obligative dhe të tjerat i anulojmë. Kërkoj sqarim për këtë qështje.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Ato shqetësime të cilat u cekën janë evidente nuk e prekin një person, por shumë persona për arsye, sepse ne të gjithë jemi të varur nga energjia elektrike. Ajo që qeveria është duke u munduar të bëjë në lidhje me këtë raport, të gjithë kapacitetin dhe autoritetin që e ka janë duke e ushtruar që të ndikojë sa më shumë dhe qështja e energjis të rregullohet sa më shpejtë. Tani është mbledhja e 10 e rregullt dhe në gjithë këto mbledhje kemi pasur mundësi dhe qasje me të gjithë qytetarët që me i paraqit shqetësimet e tyre dhe jo vetëm në fund të vitit.

Komuna e Malishevës përkatësisht qeveria Komunale e ka një program së bashku me partnerin qeverisës për zhvillimin e Malishevës urbane. Me gjithë atë kapacitet që e kemi janë orientu në rregullimin e Malishevës, e di që ka nevoja në fshatra dhe prej vitit 2013-2014 e këndeja afër 150.000m janë shtruar asfalt dhe investimet kapitale janë të orientuara më shumë në qytetin e Malishevës me e rregullu një infrastruktur dhe me ja dhënë një pamje më të bukur qytetit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkrjetar!

Vesl Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Ne i ndëgjum disa shqetësime të asambleistëve që janë me të drejtë, por fillimisht rreth shqetësimit me energji elektrike që Komuna e Malishevës me të vërtetë është duke kaluar një fazë jo të mirë. Ne si ekzekutiv kemi ngrit shqetësimet tona jo vetëm përmes një postimit por jemi marrë drejtëpërdrejt me kryesorët me telefonata deri në zgjidhjen e problemeve, sepse ka pasur defekte gjatë këtyre ditëve. Para një muaji ne kemi pasur një takim me përfaqësuesit e KEDS-it në Prishtinë, dhe kemi diskutu me menaxhmentin e tyre të cilët e kanë ngrit si shqetësim në Komunën e Malishevës për arsye të rrjetit të dobët që bartet nga Rahoveci. Kjo që ndodhi në ditët e fundit ne kemi kërkuar takim me përfaqësuesit të KOST-it por dhe me Ministren Rizvanolli, ju kemi drejtuar dhe me shënim përmes email-it zyrtar dhe me telefonata në kabinetin e tyre nuk kemi marrë asnjë përgjigjie për takim. Ne natyrisht që do të shkojmë dhe pa agjend dhe do t'i ngrisim shqetësimet tona dhe të shohim në ditët e ardhshme se si do të vepron.

KEDS-i para dy viteve ka ndarë buxhet për përmisimin e rrjetit të energjis elektrike në Komunën

e Malishevës, i ka stopu për arsye të ngritjes së çmimit të furnizimit me energji elektrike problemet e KEDS-it me qeveri, por këtë takim që e patëm u zotuan që do të përfundojnë sepse janë të kontraktuara.

Disa qështje tjera të cilat u ngritën këtu rreth investimeve kapitale, buxheti për Komunën tonë është alukuar në Maj, përveq që është bërë me vones ne kemi probleme pastaj dhe me procedurat e prokurorimit ku për disa projekte ka pasur dhe ankesa. Falë vendimit të juaj që është marrë për ridestininim të disa mjeteve ne besoj që ja kemi dalur dhe e kemi shpenzuar buxhetin mirë. Disa projekte të cilat i ceki Dritoni janë kontraktuar me vones për arsye të procedurave të prokurorimit. Unë dua të ngris një vrejtje time personale kur ne e kemi bërë një marrëveshje bashkëqeverijse i kemi orientuar pikat programore tonat dhe jemi dakorduar të funksionalizohet Malisheva urbane. Thirrja që bëre që në secilin fshatë të investohet në rrugë, kanalizime dhe në anën tjetër Malisheva urbane nuk mundemi në të dya anët. Ne jemi dakorduar që ta dërgojmë buxhetin në investime të mëdha për Malishevën urbane. Mirëmbajtja e rrugëve të cilën e ceki Vetoni ne kemi një kontrat 3vjeqare, dhe ka filluar implementimi i kësaj kontrate në disa fshatra sigurisht që nuk ka mbërri ende, sepse është kontraktuar vonë besoj që mirëmbajtja e rrugëve do të bëhet dhe dimrit dhe verës. Ne kemi pasur takim dhe me kryetarët e fshatrave ju kemi kërkuar që të na drejtohen me kërkesa, sepse ashtu kërkon procedura ligjore.

Një pyetje tjetër e bëri Labinoti për pagesat e Komiteteve po të përgjigjina në vend të Drejtorit Blerim, kemi biseduar por ka qenë vonë për me i ekzekutu të gjitha komitetet. Unë ju sigurojë që të gjitha komitetet kanë me u pagu dhe ato komitete duhet me ekzistë, sepse na bëjnë mirë neve si ekzekutiv dhe po ashtu qytetarëve. Ju kërkoj falje nëse nuk kam mundur me ju përgjigj të gjitha shqetësimeve të juaja por na duhet të shkojmë e kemi një zbulim të një lapidari në fshatin Bardhë në ora 12:00.

Argjend Thaçi: Urdhëro Avdi Morina!

Avdi Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Me të vërtet kishte shumë shqetësime për infrastruktur, kanalizime një pyetje të cilën e bëri Vetoni për ndërtimet në këtë rast për leje të ndërtimit pajtona plotësisht me ty. Qështja e ndërtimit të pompës në këtë rast brenda qytetit dhe unë kam qenë kundër dhe ende jam kundër, por lejet mjedisore nuk i lëshojmë ne, për pompa të benzinit i lëshon Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Ne lëshojmë leje vetëm për ndërtimin e objektit por jo dhe për vendosjen e rezervarëve të naftës dhe benzinës.

Mbi 18 fshatra janë bërë asfaltime të rrugëve, vetëm në fshatin Lladroc janë ndërtuar 2000m trotuar, ndërsa te qështja tjetër e rrugëve që janë paraparë me buxhetin që e keni votuar ju tashmë i kemi të kontraktuara 4 loto.

Kolektori është në procedurë.

Sa i përket energjis nuk është problemi i KEDS-it, por i Kosit dhe ndërtimi i 110kilovatshit dhe 220 kilovatësh që ka pasur të ndërtohet është problem dhe përgjegjësi e Kostit.Kuvendi i kaluar ka ndarë parcelën prej 8500m2 për ndërtimin e 220 kilovatshit, por fatketësisht kemi problem.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton!

Driton Kastrati: Pasi që unë i kisha disa shqetësime të miat dhe të banorëve të Malishevës dhe desha t'i them Valonit që shqetësimet nuk ishin të drejtuara nga Valoni, por ishin shqetësime drejtuar ekzekutivit. Unë i kam përkrahur të gjitha iniciativat e kryetarit dhe ekzekutivit. Në lidhje me përgjigjen që e dha nënkryetari, ai tha që kemi koalicion, mirëpo unë vërejtjet e mia i dhashë kryesisht rreth buxhetit të vitit të kaluar, mos zbatimit të buxhetit të vitit të kaluar. Ne e kemi përkrahur Malishevën urbane, mirëpo asnjëherë si LDK-ë nuk jemi pajtuar që mos të kryhen punët e marrura përsipër dhe fshatrat të mbesin në baltë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Ju e dini që deri para pak muajsh një organ i cili është i domosdoshëm për shqyrtimin e ankesave, në Prokurim ka qenë jo funksional dhe shumë projekte kanë mbetur pezull, në kuptimin që ka pasur ankesa dhe nuk ka mundur me u bërë zgjidhje. Tani është rregulluar kjo qështje dhe të gjitha ato prof në E-prokurim janë aktivitetet e prokurimit që e bënë Komuna e Malishevës dhe më gjërë dhe kontratat që janë të nënshkruara.

Halil Morina: Zakonisht në Kuvendet e kësaj natyre ka mazhurancë dhe mirë është që mazhuranca me u sjellë si mazhurancë e opozita me u sjellë si opozitë. Ekziston një dallim i madh në mes shqetësimit dhe zhgënjimit, dhe në moment që unë jam i zhgënjyer nga pushteti unë nuk rri pjesë e pushtetit. Secili nga ne kemi projekte që nuk janë realizuar nëpër fshatrat tonë. Midis një projektimi të buxhetit dhe realizimit është një rrugë e gjatë në mes. Buxheti është thjesht projektim i të hyrave dhe shpenzimeve dhe deri të vjenë në realizim ka plotë ndryshime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentiana!

Gentiana Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Dhe unë jam e pajtimit me të gjithë parafolësit për problemin me energji elektrike. Ajo çka më shtyri të flas është ajo që foli Vetoni që situata don zgjidhje konkrete, po mirë zgjedhne sepse mundeni me zgjedhë sepse jeni në qeveri. Ne në këtë kohë krize nuk e kemi parë asnjë reagim konkret nga Kryeministri dhe as nga Ministria, apo ata e kanë harruar komunën tonë, dhe nuk e dinë fare që jemi pjesë e Republikës së Kosovës. Kemi dhe disa deputet që janë në Parlamentin e Kosovës dhe Veton më trego a i ke dëgjuar ndonjëherë duke e ngritur një qështje ose një shqetësim për komunën tonë, apo partia e Vetëvendosjes e sheh Malishevën vetëm si tranzit në kohë të zgjedhjeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton

Veton Zogaj: Është subjekti yt që e ka votuar këtë KEDS-in dhe e ka shit distribucionin e KEDS-it dhe Minister ka qenë i parties tënde, Kryetari yt ka qenë i parties tënde deputet bashkë me 5-6 e ka ngritur dorën dhe ja ka bërë votën. Le t'më thotë Avdia dhe nënkryetari që kanë kontaktuar njërin nga deputetët. Kjo është urrejtje patologjike që keni ndaj Vetëvendosjes. Avdia asnjë mesazh dhe asnjë thirrje nuk e ka dërguar në Ministri. Ju jeni përgjegjës këtu.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Unë i bëra shqetësimet e mia dhe një e bëra direkt që lidhet me Kuvend. Në seancën e kaluar u bërë shumë zhurmë për ndihmë të bizneseve, ne si Kuvend e kemi formuar një komision dhe kërkoja përgjigje dhe e dyta kërkoja përgjigje të qështja e pagesave të komiteteve që lidhet me ty. Informatat që kam unë shpresoj që nuk janë ashtu, sepse kam informata që ka komitete që paguhen dhe nëse ndodh kështu është për të ardhur keq.

Driton Kastrati: Nëse unë dalë këtu dhe japi shqetësimet e mia, herë i interpreton në mënyrë filozofike e herë ashtu mirëpo më e pa pranushmja është ajo që e the ti dhe kërkoj që ta tërhiqesh atë fjalë sepse agjendë personale nuk ka askush. Agjenda kryesore e imja është interesi i përgjithshëm i qytetarëve

Argjend Thaçi: A keni diqka të rendi i ditës. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Në emër të grupit të Nismas, unë propozojë një pikë të rendit të ditës. Ekziston një llojë qendre që emërtohet Gjenocidi në Kosovë plagë e hapur që kryetar është Bardhyl Mahmuti dhe ka ardhur një kërkesë nga vetë kryetari që kjo shoqat ka emërtuar një simbol që përfaqëson Gjenocidin në Kosovë. Simboli i cili emërtohet Lulëkuqja me katër petale dhe kjo shoqat ka kërkuar që të legjitimohet përmes Kuvendeve Komunale të Republikës së Kosovës. Një gjë të tillë e ka bërë Kuvendi i Prishtinës, Gjilanit e plotë Kuvende të mëdha. Kështu që kërkoj që kjo pikë të hyjë si pikë e rendit të ditës dhe të emërtohet në këtë mënyrë: Kërkesa e shoqatës e Gjenocidit në Kosovë plagë e hapur që simboli lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik përkujtimor i Gjenocidit në Kosovë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Këtë propozimin e Nismas, ndoshta është mirë paraprakisht ta kemi ta kemi atë kërkesë prej Kryetarit dhe Kryesues është mirë me fillu me zbatu Rregulloren tash e tutje dhe pikën e 6 të rendit të ditës duhet me heq nga rendi i ditës, sepse nuk është votuar në seancën e kaluar dhe Rregullorja të obligon që duhet të kthehet prapë në KPF-ë dhe kjo pikë nuk ka qenë fare në KPF-ë, vetëm ka hyrë me automatizëm dhe kështu nuk lejohet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëlinda Gashi: Unë po kërkoj nga të gjithë këtu, që pika 2 dhe 3, pasi që nuk janë drejtorët prezent të hiqen nga rendi i ditës.

Argjend Thaçi: Prezent e kemi zyrtarin për Integritet.

Mirëlinda Gashi: Pra, pikën e tretë kërkoj që të largohet nga rendi i ditës.

Burim Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam një propozim, që tek pika 6 që këtë kërkesë e kemi votuar kundër, sepse kemi kërkuar që kjo pikë të sjellet me dokumentacion e kompletuar, që ne të kemi mundësi ta analizojmë se

me cilat prona saktë ka të bëjë. Unë po shohë që nëse sot na vjen një material i tillë ne nuk kemi kohë që ta analizojmë saktë se me cilat prona ka të bëjë në Komunën e Malishevës dhe pajtohem me mendimin e Vetonit që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës.

Argjend Thaçi: Kush është për propozimin e Halilit, që të futet në rend të ditës që Lulkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i Gjenocidit në Kosovë. Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 3.

Kalojmë te propozimi i Vetonit, që pika e 6 të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?

Për: 8

Kundër: 14

Abstenim: 1

Kush është për votimin e rendit të ditës si tërsi?

Për: 16

Kundër: 4

Abstenim: 3

Kalojmë në pikën e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi i Raportit vjetor të Integritetit për vitin 2022. Urdhëro, Albrim Paqarizi.

Albrim Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë jam Albrim Paqarizi, zyrtar për Integritete Europiane dhe sot do e prezantoj Planin e hartimit të Integritetit. Raporti vjetor i këtij Plani me përmbajtje parasheh deklaratën e Integritetit, hyrjen, drejtoritë, prokurimin publik, drejtorin për Financa dhe Ekonomi, Drejtorin për Administratë, Planifikim Urban dhe Rural, standarde të ndërtimit dhe kontrollit, inspektimet të arsimit publik, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, shërbimet publike dhe licencimi i shërbimeve, komunikimi dhe informimi i institucionit dhe me palë të jashtme të interesit, Gjeodezi kadastrë dhe pronë. Deklarata e integritetit është gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikën, etikën kulturore dhe organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata është e mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë dhe Vetëqeverisjen Lokale dhe aktet e tjera komunale rregulluese. Deklarata e integritetit dhe Plani i Integritetit ka synuar dhe ndihmuar drejtpërdrejtë në raportin e punës vjetore për vitin 2022 si dhe në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modelizuar. Plani i Integritetit ka ndikuar që Raporti i Integritetit Komunal të përmbushet me objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike. Të gjeturat brenda vitit në mënyrë sistematike dhe standarde janë parimet dhe objektivat për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljet tjera të paligjshme dhe jo profesionale të organeve që janë pjesë komunale. Raporti i Integritetit është bazuar në Planin e Integritetit dhe të objektiveve dhe kemi të arritura ku frenimit e fenomeneve negative të cilat zbehin dhe sanksionojnë komunën. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Faleminderit zyrtarit për Integrime Europiane, përkatësisht Albrim Paqarizit për Raportin. Ajo çka më interesoj që në kuadër të këtij Raporti u cek dhe auditimi dhe në fakt kam një pyetje se a është funksional Komiteti i Auditimit. Nuk i kemi këtu asnjë zyrtar nga qeveria, mirëpo sa e di unë Komiteti i Auditimit nuk është funksional, për shkak të disa ndryshimeve të cilat kanë ndodhur dhe ka pasur lëvizje të anëtarëve që kanë qenë pjesë i atij Komiteti.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Faleminderit Albrim për prezantimin. Disa dilema për këtë Plan këtë Raport e kemi pasur dhe në KPF-ë, të cilat i kemi diskutuar mirëpo ndoshta nuk do ishte keq me i diskutu prapë këtu për hirë të opinionit publik. Dilema ka qenë për Drejtorin e Administratës që ai e ka bërë një lloj Raporti, një lloj vlerësimi të gjitha drejtorive dhe organeve të tjera komunale që janë të involvime në këtë Raport. A ka bazë ligjore një drejtor me i vlerësu dhe drejtorët e tjerë, sepse në fund të këtij Raporti është nënshkrimi i Drejtorit. Pra, sa ka kompetencë ligjore që ai duke qenë drejtorë me bërë vlerësim për drejtorët tjerë. Këto dilema i ka pasur dhe Muharremim, më shumë dilema ligjore që e kemi marrur një përgjigje jo të kënaqshme prej Izetit dhe do ishte mirë me qenë prezent drejtori dhe të na përgjigjet që mbi qfarë baze i ka bërë verimet. Në Planin e Integritetit mirë që është bërë, sepse në vitet tjera nuk është bërë një plan i tillë. Ky Plan apo Raport i Integritetit bjen ndesh me Raportin paraprak që e kemi pasur në seancat e kaluar Planin për Transparencë. Zyrtari për Transparencë që e ka prezantuar para nesh Raportin i ka renditur një varg shkeljesh, një varg gjeturash që i ka parë, që komuna ka dalë keq në disa dikaster dhe që atëherë përgjigja e zyrtarëve të qeverisë që shumë punë janë kryer mirëpo nuk janë regjistruar në raportin për transparencë, ndërsa në anën tjetër ky Raport i vlerëson të gjitha drejtorit dhe ka notë pozitive pothuajse për të gjitha drejtoritë, përjashtoj këtu për Prokurimin i cili jep disa rekomandime. A është valid ky Raport i Integritetit apo është valid Raporti për Transparencë, sepse komuna asnjëherë spo është përfituese e granteve që ipen për Transparencë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Albrim!

Albrim Paqarizi: Në Raport nuk janë të përfshira brisqet dhe Raportet të Planit të Integritetit. Unë nuk jam as koordinator as në grup punues të këtij Planit, unë sot jam vetëm prezantues, mirëpo për herave të tjera ne kemi shumë të vetëdishme se si hartohet dhe monitorohet ky Plan i Integritetit.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e Planit vjetor të Integritetit për vitin 2022?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 18 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shkojmë në pauzë.

Kalojmë në pikën e katërt : Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete.
Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Ky komitet është i përbërë nga 5 anëtar, dy anëtar nga kuvendi, dy nga komiteti i pakicë dhe një përfaqësues i bizneseve. Gjatë gjithë kësaj kohe të gjithë anëtarët kanë qenë të rregullt në takime dhe kanë ngritur qështje me interes për qytetarët e komunës së Malishevës pa dallim etnie. Sigurisht që jemi të njoftuar për planin e punës për vitin 2022, i falenderoj të gjithë anëtarët për gjithë angazhimin dhe punën që e kanë bërë. Kryesues i Komitetit për Komunitete është pjesë e këshillit komunal për siguri në bashkësi, ku në këtë këshill kemi ngritur qështje të ndryshme të cilat janë paraqitur nga anëtarët e këtij Komiteti.

Bashkëpunim tjetër kemi pasur dhe me shërbimin e nevojave të mira të komunave për rreth. Të gjitha mbledhjet e këtij komiteti janë të monitoruara nga OSBE-ja ku jemi vlersuar maksimalisht për punën dhe angazhimin të gjithë antarët e komitetit duke u renditur si Komuna më e suksesshme në realizimin e planit të punës, realizimin e takimeve dhe ndihmën e komitetit pakicë. Në Malishevë jetojnë 56 banorë të komitetit pakicë. Në këtë raport janë të përfshira raporte dhe aktivitetet të realizuara në teren, takime me institucione të ndryshme lokale në Malishevë. Si rekomandime të ndalura nga ky raport për aktivitetet për vitin 2022 të këtij komiteti po i ceki disa prej tyre: Përkrahje për zgjerim të biznesit në Banjë, për mos shuarje është mirë që Komuna të marrë parasysh këtë kërkesë që me të përkrah, rregullim i infrastrukturës në raport janë të specifikuara, përfshirjen e të rinjve të komitetit pakicë në aktivitetet kulturore rinore dhe sportive që ka qenë i mangët, avolvim për fusha të ndryshme, përkrahje me subvencione bujqësore, përkrahje dhe motivim për themelimin e një organizate jo qeveritare të komitetit pakicë, përkrahje për qendër rehabilitimi në Malishevë, krijimi i mundësive për qasje në objekt rregullimin të vjerrinave në trotuare, zebra për personat me nevojë të veçanta. Pensionistët kanë nevojë për përkrahje dhe subvencione, ndihma për pako ushqimore dhe higjienike, përkrahje dhe motivim nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit për vijueshmërinë e fëmijëve në shkollë, përkrahje me bursa për student, rexhistrim dhe pranim në qerdhe të fëmijëve të komitetit pakicë, krijim i mundësive për punësim të komitetit për pakicë, po ashtu ndërtimin e shtëpisë për familjen Muharrem Islamaj nga fshati Stapanicë. Kërkoj bashkëpunimin tuaj me kërkesat e juaja të cilat mund të përfshihen në planin e punës për vitin 2023.

Argjend Thaçi: Faleminderit Amrush, urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje!

Në KPF e kam diskutuar raportin e Komitetit dhe e përgëzoj Amrushin për detajet të cilat i ka specifikuar, për numrin e madh të mbledhjeve që i ka mbajtur. Ka specifikuar shumë tema dhe ajo çka më tërmeqen vëmendjen më shumë janë dy qështje: e ceki që janë 56 anëtar të këtij komiteti dhe prej tyre asnjë fëmijë nuk është i regjistruar në qerdhe publike, kjo është një vërejtje e madhe për Komunitetin tonë. Po ashtu shqetësuese është dhe mos angazhimi i tyre në punë, vetëm dy punëtor në stafin teknik. Nuk jam duke parë në institucione tjera qoftë mësimdhënës apo ndonjë institucion tjetër. A i keni vizituar këto familje dhe ndonjëri a ka kualifikim universitar dhe a aplikojnë në vende të ndryshme të punës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesues!

Faleminderit dhe Komitetit për punën që e kanë bërë. Konsideroj që këto kanë me qenë motiv dhe shtytje që na me i trajtu në një formë më të veçantë dhe ashtu nuk janë në numër të madh dhe konsideroj që kemi hapsirë me ju dhënë një trajtim më të veçantë. Te bursat pyetja ime është kështu: A ka rast që dikush nga këta komunitete kanë aplikuar për me qenë përfitues të bursës dhe nuk janë përfitues të bursës?

Çka mundemi me bërë ne si kuvend, që fëmijet e këtij komuniteti t'i nxisim që të jenë sa më

shumë të kyqur në shkolla apo ku do qoftë tjetër në institucione publike. A keni mundur ju si Komitet me nxjerr diqka që atyre ju mungon ose me i motivu që ata me qenë të kyqur dhe jo të qëndrojnë anash nga shoqëria?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Konsideroj që ky Komitet i ka përfunduar detyrat e veta konform obligimeve ligjore të cilat i ka pasur. I ka mbajtur të gjitha mbledhjet, i ka specifikuar të gjitha në raport i përgëzoi për këtë punë. Është obligim i joni së pari njerëzor pastaj kushtetues që të ju dhurojmë hapsira, nëse ka pasur fëmijë që ka apliku në qerdhe dhe nuk është pranuar nuk besoj që ka mundur me ndodhë kjo. I inkurajoj këta anëtar të këtij Komiteti që ti nxisin qoftë të i dërgojnë fëmijët në qerdhe, qoftë me i nxit për shkollim ose në punësim .

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Të përgëzoj për punën të cilën e keni bërë në këtë komitet, besoj që i keni parapa që këto rekomandime me i dërgu te Kryetari dhe te secila Drejtori që këto mos të mbesin vetëm në letër por ekzekutivi me i marrë parasysh më shumë në të ardhmen.

Argjend Thaçi: Urdhëro Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Unë kërkoj që këto familje që i kemi në komunën tonë të i vizitojmë, ti ofrojmë kushte më të mira, dhe bibliotekën që e kemi komunale të kenë hapsirë që ti kenë librat të cilët ju konvenojnë. Nuk e di a i keni bërë vizitë, sepse edhe kjo pjesë duhet të përfshihet në raport.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Faleminderit të gjithëve për komentet dhe pyetjet. Veton, në bazë të takimeve që i kemi mbajtur me Drejtorin e Arsimit nuk ka pasur aplikime të këtyre familjeve për regjistrim të fëmijëve në qerdhe. Ne e kemi ngrit si shqetësim gjatë kontaktit me këto familje që në të ardhmen të pranohen fëmijet sigurisht në bazë të kriterëve, por të ju dhurohet hapsira që të pranohen në qerdhe. Ne së bashku me anëtarët e Komitetit kemi realizu vizita në teren dhe janë dy raste që punojnë janë punëtor teknik, nuk kanë shkollim adekuat përveq punë teknike me punu. Kërkesa është më shumë me i ndihmu me pako ushqimore, higjienike, dhe falë donatorëve ne e kemi realizu dhe ju kemi ndihmu gjatë këtij viti. Po ashtu dhe nga Komuna sa herë që ka pasur ndihma janë përfshi dhe këto 12 familje të komunitetit, të gjithë janë përfitues të skemës sociale.

Për momentin është vetëm një student nga Banja është në vitin e parë të studimeve dhe nuk ka aplikuar për bursë, pra nuk është përfitues burse. Sa i përket motivimit te vijueshmëria e nxënësve deri më tani që këta nxënës të komunitetit të cilët i vijnë mësimet në shkolla janë të rregullt, dhe në bazë të takimeve të cilët i kemi mbajtur me Drejtoreshën e shkollës në Malishevë dhe në

banjë ata e kanë paraqitur një bashkëpunim shumë të mirë, janë të barabartë nuk janë të diskriminuar në asnjë moment.

Sa i përket rekomandimeve të cilat i kemi shenuar do i dërgojmë dhe te Kryetari i komunës dhe te dikasteret tjerë në Drejtori Komunale. Nëse keni ndonjë kërkesë sikurse Mirëllinda të cilën e ceki rastin për bibliotek jemi të gatshëm me i marrë ato kërkesa dhe ti vendosim në planin e punës për vitin 2023.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete. Kush është për?

Me vota unanime konsideroj që kjo pikë është aprovuar.

Kalojmë te pika e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Në këtë hartim të draft Planit kemi qenë të gjitha subjektet politike dhe kemi dhënë kontributin tonë. Qështjet që i kemi pasur që të futen, i kemi futur në draft Plan dhe jemi për këtë pikë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda!

Mirëllinda Gashi: Dhe grupi jonë nga PDK-ja e mbështesim këtë Plan.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Ne si grup i NISMA-s e mbështesim këtë Plan.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e Planit tëpunës së Kuvendit për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pikë është aprovuar.

Kalojmë te pika tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/300 datë: 07.12.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për miratimin e e listës së pronave të paluajtshme të Komunës. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Arsyet që në fillim të seancës kërkoja që të largohet kjo pikë janë dy: e para që në seancën e kaluar nuk i ka marrur votat e mjaftueshme me një arsyetim që e kemi ngritur të gjitha grupet politike që të vjen kërkesa e kompletuar dhe ne këtu kemi vetëm një list me shifra që pak nga ne mundën me i kuptu. Ne i kemi kërkuar drejtorisë për kadastër që të vjen me prona të specifikuara, ku janë me parcela dhe ku po kërkohen, pastaj nuk është problem me votu. Këtë fare nuk e ka sjellë drejtoria e kadastrit dhe realisht nuk e ka kthyer as në komitet, se a i ka përmbush ato kërkesa drejtoria. Ne si grup i Vetëvendosjes, në moment që të hedhet në votim ne dalim jashtë sallës dhe nuk marrim pjesë fare në proces.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi: Unë mendoj që kjo qështja e pronës është shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme për qytetarët e Malishevës. Ne dhe në seancën e kaluar e kemi cekur që kjo kërkesë

duhet të jetë më specifike dhe më e detajuar, që ne sot me kalu. Jemi në rregull që pronat duhet të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë, mirëpo si me u shfrytëzu. Le të vjen kërkesa me skica, e detajuar dhe ta dimë për secilën pronë se çka po bëhet dhe cili është interesi i përgjithshëm i Komunës dhe i qytetarëve të Malishevës. Ne me këtë kërkesë ashtu siq kemi votuar në seancën e kaluar dhe tani jemi kundër nëse nuk vjen një Raport më i detajuar. Ne si grup i PDK e lirojmë sallën.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Ne e kemi një pikë të rendit të ditës që është e rëndësishme për interesin e komunës tonë dhe ne e dimë që është obligim ligjor që një vit para të listohen të gjitha ato prona të komunës të cilat potencialisht mund të jepen në shfrytëzim në forma të ndryshme, nëse është interesi i komunës së Malishevës. Ne nuk jemi duke i dhënë këto prona në shfrytëzim dhe të gjithë ne e dimë cilat janë proceduar për me dhënë në shfrytëzim një pronë. Për ne është e domosdoshme me i dhënë kahje sot sepse nëse sot ne nuk i japim ne tani jemi në fund vit dhe për vitin e ardhshëm ne nuk e kemi asnjë pronë të gatshme për ta dhënë në shfrytëzim, nuk mundemi as pishinën e Banjës ta japim në shfrytëzim. Nuk do të thotë që ne kemi dhënë në shfrytëzim të gjithë ato prona. Nëse dikush ka ndonjë shqetësim për një pronë ne nuk e japim në shfrytëzim nëse nuk është në dobi të Komunës dhe qytetarëve. Po flas që thjeshtë me ja hapur rrugën që nesër me pas mundësi që me dhënë në shfrytëzim një pronë që ka me i sjellë të mira komunës tonë. Ne po dojmë me ditë sa prona i kem dhe sa prona janë të gatshme për shfrytëzim dhe pastaj për secilën veq e veq i kemi procedurat, ligjet, rregulloret siç jepen në shfrytëzim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Ne e kemi trajtuar si pikë dhe në mbledhjen e kaluar dhe përveq Nebihut që ka qenë konkret në një pronë të caktuar në fshatin Lladroc, që nuk i hynë punë asnjë veprimtarie përveq gurëthyesit për shkak të pozicionit ose figuracionit. Ajo çka po më shqetëson është qasja e Burimit që kërkon ti bëjë skicat për 151 parcelave, që potencialisht mund të jenë të dhëna në shfrytëzim nga Komuna e Malishevës. Ne e caktojmë koson ose tarifen që ka me paguar shfrytëzuesi dhe a do ja japim dritën jeshile apo jo. Nëse ne nuk e japim këtë aprovim, atëherë Agjensioni kadastral dhe Ministrietë përkatëse nuk kanë me leje që asnjë asnjë pronë e komunës së Malishevës të jepet në shfrytëzim. Përderisa secila pronë ka me u trajtuar veq e veq, pse kemi nevojë me bërë stazh skicat, sepse për ti bërë të gjitha skica e atyre pronave duhet 2-3 muaj të punohet për këtë lëmi. Këtu jemi që ti mbrojmë interesin e të gjithë qytetarëve, pa dallime. Para se të jepet një pronë duhet të respektohet kjo procedurë dhe që të zbatohet kjo procedurë duhet ti jepet aprovim. Burim, me veprimin e sodit ju jeni pengesë e zzhvillimit sepse ju po na mohoni të drejtën kryetarit Ekrem Kastrati që nesër një investitorit nga diaspora mos të ketë mundësi ku me investu.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi: Kjo qështje nuk është që ne nuk dëshirojmë t'i japim në shfrytëzim pronat ose nuk dëshirojmë t'i ndihmojmë qytetarët, ose investitorëve potencialisht që kanë ide të mira për zhvillim e ne nuk kemi me i ndihmu. Ne jemi për t'i ndihmuar qytetarëve dhe gjithë atyre që mendojnë me e zhvillu qytetin. Ne dhe në seancën e kaluar kemi kërkuar që të na vjen një Raport më i detajuar dhe nuk kemi nevojë me u ngut me marr vendime që ne nuk kemi sqarim për cilat prona bëhet fjalë. Le të vijë secili investitor potencialisht ka ide ne kemi me i mbështet dhe ne kemi dhënë Pishinën e Banjës për dy vite, kemi dhënë prona për 99 vjet dhe kemi ndarë parcela të ndryshme prej këti Kuvendi. Në këtë moment unë nuk e kam të qartë që mundem me votu. Për mos me ardhur te disa elemente, të cilat në të ardhmen mundën me qenë pengesë për qytetarët dhe banorët e fshatrav të ndryshme, unë votoj kundër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Unë e kam të qartë që kemi me votuar një list e cila duhet dhe kërkohet sipas ligjit paraprakisht me u evidentu disa prej pronave komunale, të cilat mund të jepen në shfrytëzim për vitin që vjen. Të gjitha pronat që i kemi dhënë ato kanë pasur një list të miratuar paraprakisht. Nuk ka mundësi teknikisht me i sjellë skicat për të gjitha këto prona. Nëse ju mendoni që mundemi me ja dha një investitori një pronë nëse nuk e miratoni këtë list, dil nëse dëshiron, unë jap dorheqje prej asambles, mirëpo a e bënë ti dhe këtë gjë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi: Unë nuk jam mos mi qu këto përptra, mirëpo ideja është të kemi një Raport më të saktë dhe më të detajuar se çka jemi duke votuar. Seancat që i kemi në vitin 2023 le të vjen Raporti më i detajuar dhe ne do e votojmë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Në seancën e kaluar e kemi shtjerrur debatin për këtë pikë, dhe kemi kërkuar një detajim, një specifikim më të madh prej Drejtorisë së Gjeodezis, të cilën nuk e ka bërë. Ajo ka qenë e detyruar ta bëjë një gjë të tillë dhe ta sjellë në KPF-ë e pastajta sjellim në Kuvend. Pasi drejtorja nuk e ka bërë një gjë të tillë, neve nuk na mbetet asgjë tjetër pos me vepru në mënyrën më demokratike të mundshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: A është e drejtë që kuvendi të kërkoj specifikime e material shtesë, unë konsideroj që është e drejtë. Të njejtin shqetësim që e ngriti Nebihu dhe unë e kam ngritur për disa prona që janë në zonë kadastrale të Kijevës. Kam kërkuar sqarim nga drejtori se ku janë më saktësisht këto prona dhe i kam specifikuar dy prona komunale në mes të fshatit dhe unë nuk kam marr përgjigje. Ai është shqetësimi ynë dhe e kam thënë dhe atë ditë në seancë kur është qështja e pronave duhet të trajtohet me seriozitet, duke e parë të kaluarën se çka është ka ndodhë me pronat në komunë të Malishevës. Unë kërkoj dhe nga ekzekutivi e posaqërisht nga drejtori që

përveq kësaj list të na sjellë dhe një list me pronat komunale, objekte afariste që janë të dhëna me qira dhe që sa ekziston ky Kuvend ne nuk kemi të dhëna që a kemi të hyra nga ato prona. E kemi qështjen e Belakut që e kanë bllokuar pronën për 10 vite për shkak të procedurave dhe nuk është dhënë asgjë. E kemi qështjen e pronës në Dragobil, qështjen e gurthyesve dhe nuk është dhënë asgjë. Tani e kemi dhe një pikë të rendit të ditës që i kemi kërkuar Raport për shërbimet e varrimit dhe si Kuvend kurrfar informacione nuk kemi. Realisht me ose pa dashje po injorohemi dhe ky është adresimi dhe shqetësimi ynë dhe unë për këto arsye atë ditë kam dhënë voton kundër dhe sot e kam votën kundër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Kishte me qenë absurde dhe e pa kuptim nëse ne jemi vendosur sot me thënë një pronë në shfrytëzim dhe nuk kemi as skicë të asaj prone dhe nuk e dim as për çka po e japim as ku po e japim. Do ishte plotësisht e drejtë me reagu këtu se çka jeni duke bërë dhe po votoni pa e ditur se çka po jepni shfrytëzim. Ne nuk jemi duke e dhënë në shfrytëzim, por ne po e votojmë listen e pronave që janë të gatshme me u dhënë në shfrytëzim. Nëse është një pronë që është shqetësim i qytetarëve nuk kemi me e dhënë në shfrytëzim. Nëse kemi shqetësime të dy tri prona të cilat me hametsimet tona mundemi me e llogarit që kanë me u dhënë në shfrytëzim në mënyrë jo të drejtë, ose kanë me shkaktuar problematikë të ati lokacioni, mos ti marrim në qafë 150 prona tjera. Në mbledhjen tjetër kemi me bërë një kërkesë së cilat prona të komunës janë të dhëna në shfrytëzim, qoftë me qira apo forma të tjera dhe sa të hyra merr komuna prej këtyre pronave që janë me qira. Unë propozoj një pauz 5 minuta me shfat e grupeve që të kordinohemi dhe njëherë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton!

Driton Kastrati: Ligji e parasheh që deri me 31 dhjetor lista e përgjithshme dhe lista e veqantë të aprovohet në Kuvend, dhe asgjë nuk ka kundërligjore. Nëse nuk aprovohet lista dhe ti pamundësohet dhënia e pronave kuvenid komunal, unë mendoj që është një humbje për të gjithë qytetarët e Malishevës. Te qështja e kërkesës së Rregullores, unë kisha kërkuar një sqarim nga Muharremi se mos po bëjmë ndonjë shkelje ligjore të na jep sqarime që lista e veqantë sidomos a i përmban të gjitha elementet që kërkohen sipas Rregullores përkatëse. Nëse ne nuk bëjmë ndonjë shkelje ligjore dhe lista i përmbush të gjitha kriteret që kërkohen me Ligj dhe Rregullore, unë mendoj që duhet të jepet aprovimi nga ky Kuvend.

Për Muharremin e kam dhe një qështje shkresa e cila na ka ardhur në email lidhur me këtë pikë, parashtruesi i kësaj kërkesë është Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër dhe drejtori përkatës Bashkim Krasniqi, por jo nga Kryetari a është ndonjë pengesë e rëndësishme qoftë dhe teknike që mos të bjen poshtë kjo kërkesë. Muharrem këtë kërkesë a do të duhet që të na bëjë kryetari, po Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër. Nëse Muharremi e konsideron që nuk ka ndonjë telashe, unë jam për.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Faleminderit, Kryesues!

Drejtori i Gjeodezisë ka aprovimin dhe të kryetarit për me ju drejtu në këtë rast kuvendit . Shkresa ka ardhur prej Ministries së Pushtetit Lokal si shkresë njoftuese, ose paranoftuse, sepse afati i fundit për aprovimin e listes është 31 dhjetori. Kjo është një ofertë që komuna ju bënë qytetarëve, bizneseve që këto prona janë të lira që mundemi me i dhënë në shfrytëzim dhe për vitin 2023 qytetarët kanë me u përcaktuar në ato zona ku kanë nevojë me i pasur bizneset e tyre, e bëjnë kërkesën dhe kryetari kërkesën e tyre e përcjellë në kuvend dhe pastaj hapet procedura a me dhënë në afat të shkurtër apo afatgjatë. Lista me skica merrr kohë, dhe unë nuk besoj që një pronë e cila ka kontekst gjyqësor është në atë list, mirëpo secila pronë që mendoni që ka një pengesë ju mundeni me e heq nga lista dhe me rregullu. Ju prapë mundeni me bërë një zgjidhje për mos me e blloku këtë proces për vitin 2023, me votu listen dhe me urdhëru Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër që në momentin kur bëhet publikimi i listes të bëhet publikimi me skica. Nëse ju nuk e kaloni këtë pikë, problemi do të ishte që qdo kërkesë që i drejtohet kuvendit komunal, ne e votojm këtu e kalojm dhe në momentin që vendimi shkon në Ministri ajo thotë që nuk është në listen e publikimit që duhet të bëhet një vit para dhe për këtë votim të juajin ajo mbetet pa u shqyrtuar deri në vitin 2024. Sa i përket listes së drejtorisë është në pajtim me ligjin dhe kërkesa është ligjor.

Argjend Thaçi: Shkojmë në një pauz 10 min me shefat e grupeve.

Grupi nga VV-ja, grupi nga PDK-ja dhe Labinot Gashi lëshojnë sallën.

Argjend Thaçi: Pjesmarrës në sallë janë 15 asambleistë. Kurum nuk kemi dhe nuk mund të vazhdojmë seacën. Për vazhdimin e mbledhjes ju njoftojmë. Faleminderit për prezencën.

Përfundoi në ora: 14:50.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

